



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:092828

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730643

PKR.nr.210/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Krimeve të Rënda—në përbërje nga Kryetarja e trupit gjykues – Gjyqtarja Alltën Murseli, anëtarët – gjyqtarët profesional, Gazmend Bahtiri dhe Gëzim Ademi, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.M për shkak të veprës penale Vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.nr. 860-10/12 të dt. 29.03.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor te dt.22.03.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë Dulina Hamiti, i dëmtuari M.H, i akuzuari B.M me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av, Naim Rudari, me datën 27.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 26.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.M, nga i ati N., e ëma V. e gjinisë S. i lindur më ... në fsh. ..., Komuna e ..., ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit nga data 13.11.2012 deri me 30.01.2013 dhe në masën e arrestit shtëpiak nga data 30.01.2013 deri me datë 01.03.2013.

Në bazë të nenit 363 par. 1 nën par. 1. 3 të KPPRK-së;

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

Me datë 13.10.2012, rreth orës 22:05 minuta, në fsh. ... të Podujevës , me dashje ka ndërmarr veprime të drejtëpërdrejta për kryerjen e vrasjes së viktimës M.H , por veprën nuk e ka përfunduar në atë mënyrë që, pasi i'a ka bllokuar rrugën të dëmtuarit duke e ndalur xhipin e vet " ... " para veturës së tij "... " me targa ... ka shkruar te ai dhe posa e ka ndalur veturën e ka qel xhamin e derës, nga hapësira e saj fillimisht i është drejtuar me ton kërcënues me pyetjen " Cka po lyp ti knena", pastaj ka futur dorën brenda veturës dhe me kondakun e pistoletës e ka goditur një herë të dëmtuarin duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore në formë të plagëve ndrydhëse – shqyese në kokë, si pjesë vitale të trupit, ndërsa kur i dëmtuari është shtyrë me të pandehurin që të i'a marr pistoletën nga dora, i pandehuri ka shkrepur një herë në drejtim të viktimës dhe i ka shkaktuar plagë skillopëtare në nëngjurin e majte, me ç'rast dëshmitari A.TH ka dalë nga vetura e të dëmtuarit dhe ka shkruar te i pandehuri të cilit i ka thënë " mos shkrep me pistoletë dhe e ka larguar të pandehurin, i cili pasi që është kthyer në veturën e vet është nisur në drejtim liqenit të Batllavës, ndërsa i dëmtuari nga dhembjet e pësuar ka dalë nga vetura prej derës së përparme e djathtë, por është rrëzuar 2,3 m larg saj dhe prap kthyer me ndihëm e dëshmitarit B.J, tani në ulësen afër shoferit, pastaj dëshmitari A.TH me ç'rast e ka drejtuar këtë veturë dhe e ka dërguar të dëmtuarin në emergjencën e Podujevës, ku i është ofruar ndihma e parë prej nga me auto- ambulancë është transportuar në QKUK në Prishtinë ku pas ndërhyrjes mjekësore ka arrit t'i mbijetoj plagët e pësuar trupore me çka vepra ka ngel në tentativë.

- me ç'rast kishte për të kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së.

- Pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.
- Shpenzimet e procedurës penale për këtë vepër penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.
- Pala e dëmtuar M.H nga ... Rr'' ...'', për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko civil

Konform nenit 362 par.1 nën par.1.3 të KPPRK-së:

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

Pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve në shtëpinë e vet në fsh ... të Podujevës, deri më datë 13.10.2012 ka mbajtur në pronësi pistoletën e kal ... , pa nr serik, të markës së panjohur, ndërsa me datë 13.11.2012 ka mbajtur në pronësi pistoletën ‘’...’’ me nr.serik ...me tetë fishek të kal ..., kur i është konfiskuar gjatë arrestimit të tij në Prishtinë.

- me ç’rast kishte për të kryer veprën penale Mbajtja në pronësi të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

- Pasi që vepra penale është përfshirë në amnisti me Ligjin për Amnisti 04L/- 209 i vitit 2013.

- Konform nenit 374 par.3 të KPRK-së, konfiskohet arma e tipit:’’ ... me tetë fishek te kalibrit ...

- Shpenzimet procedurale për këtë veprë penale bien barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës.

Arsyetimi

Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda me aktakuzën PP.nr 860-10/12 ntë dt 29.03.2013, ka akuzuar të akuzuarit B.M për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së dhe Mbajtja në pronësi të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së dhe kundër të pandehurit P.G, për shkak të veprës penale Dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale nga neni 305 par.2 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje sa i përket të pandehurit P.G, gjykata me Aktvendimin PKR.nr ... të dt 24.03.2023 e ka hudhur aktakuzën dhe e ka pushuar procedurën penale për shkak se për veprën penale për të cilën është akuzuar, kishte arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, në kuptim të dispozitës së nenit 90 par.4, në par 1.5 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale për të akuzuarin B.M gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 18.07.2023, në të cilin i akuzuari është deklaruar rreth fajësisë, ndërsa i njëjti nuk e ka pranuar fajësinë për vepra penale të cilat i viheshin në barrë.

Pasi që i akuzuari nuk e kanë pranuar fajësinë, gjykata duke u bazuar në nenin 323 par. 1 nën paragrafi 1.2 të KPPRK-së, ka vazhduar me fjalën hyrëse, me prezantimin e provave personale dhe materiale dhe me fjalën përfundimtare të palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurorja e Shtetit në fjalën përfundimtare të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor i ka përmbledhur dhe përshkruar provat personale dhe materiale të cilat argumentojnë faktet në lidhje me veprimet e të akuzuarit të përshkruara si në dispozitiv të aktakuzës, dhe përfundimisht gjykatës i ka propozuar që të njëjtin të shpall fajtor dhe të dënoj në bazë të ligjit dhe me rastin e marrjes së vendimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë rënduese ka propozuar që gjykata të ketë parasyshë mënyrën e kryerjes së veprës penale, pesha e veprës penale dhe pasoja e shkaktuar tek i dëmtuari Milot Hasani.

I dëmtuari Milot Hasani në fjalën përfundimtare ka deklaruar: dua drejtësi dhe dënim maksimal, po ashtu kërkoj kompensim dëmi.

Fjala përfundimtare e mbrojtësit të akuzuarit Av. Naim Rudari.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.M, Av. Naim Rudari, në fjalën përfundimtare ka deklaruar fjalën përfundimtare e ka përgatitur me shkrim dhe e ka elaboruar në seancë, duke konsideruar se nuk është provuar aktakuza e prokurorisë dhe gjykatës i ka propozuar të akuzuarin ta liroj nga Aktakuza, e pretendimet se nisur nga deklarata e të dëmtuarit M.H të dhënë në polici, i njëjti pyetjes së zyrtarit policor se “Kur të ka gjuatjur me armë B. a ka mundur me të vra, i njëjti është përgjigjur: “ po, ka mundur mirëpo mendoj se nuk e ka pasur për qëllim me em vra por ndoshta të më frikësoj, nuk e di arsyen përse e ka bërë këtë”. Bazuar në dëshminë e dëshmitarit të dhënë në prokurori, i njëjti ka deklaruar se “ Unë nuk e kam me revole apo ndonjë mjet tjetër në duart e B. dhe të atij tjetrit, as në momentin kur ka zhdryp prej kerrit të tyre e erdhën tek kerri jonë, e as në momentin kur u kthyen në kerrin e ture. Ku kerr është nal në traken e vet normal”. Gjithashtu dëshmitari A.TH kishte deklaruar në prokurori se i pandehuri B.nuk mbante asgjë në duar. Gjithashtu i njëjti ka pretenduar se edhe deklaramet dhe dëshmitë e tyre të dhëna në shqyrtime gjyqësore nuk u vërtetua dyshimi i bazuar mirë se, pasi që prokuroria në aktin akuzues për vrasje në tentativë vetëm e ka përshkruar në një vend se “ me dashje ka ndër marr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e vrasjes së viktimës M.H , por nuk e ka përfunduar në atë mënyrë që..” dhe në fund të përshkrimit të dispozitivit ka përshkruar se “ ku ka pas ndërhyrje mjekësore ka arritë t’i mbijetoj plagët e pësuar trupore me çka vepra ka ngelë në tentativë”. Prokuroria nuk ka përmendur asnjë pengesë apo vështirësi që ka pasur B.M që të kryente vrasjen , nëse ka pasur qëllim të tillë dhe cilat ishin pengesat për të realizuar ai qëllimin e vet , e që vepra ngeli në tentativë, apo kishte rrethana që B.M ka hequr dorë nga vrasja. Andaj mbrojtja konsideron se nuk ka ekzistuar qëllimi, dashja për kryerjen e veprës penale Vrasja, sikur i mbrojturi i tij do të dëshironte të kryente veprën penale të Vrasjes, i njëjti do ta kryente , pasi që nuk ka pasur asnjë pengesë për të kryer një veprim të tillë. Prokuroria e ka paragjykuar dhe supozuar qëllimin që ka pasur B.M atë ditë. Në rastin konkret nuk mund të flitet as për heqjen dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale vrasja, pasi që B.M nuk ka pasur për qëllim, për asnjë moment kryerjen e veprës penale, sepse nuk ka pasur motiv , shkas e as arsye të më hershme që ai për të vendosur për të kryer veprën penale të vrasjes. Mbrojtja gjithashtu është thirrë edhe në eskpertzën mjeko ligjore ku është konstatuar lëndimi i lehtë trupor tek i dëmtuari M.H, e në rast se kemi të bëjmë me vepër penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 153 par, 1 në këtë çështje arrihet parashkrimi absolut i ndjekjes penale, koform nenit 90 të KPPK-së. Ndërsa sa i përket veprës penale Mbajtja

në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, prokuroria ka përdorur ligjin më të favorshëm të vitit 2013, e ku në bazë të dispozitës ligjore ka arritur parashkrimi absolut i veprës penale. Mbi të lartcekurat mbrojtësi i të pandehurit ka kërkuar që ndaj të pandehurit B.M të merret Aktgjykim Lirues, ngase nuk është provuar se pandehuri ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë.

I akuzuari B.M, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrahë fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij dhe nuk ka tjetër se çfarë të shtoj.

Provat e administruara dhe të vlerësuara

Gjykata lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike ka administruar provat personale siç janë dëshmia e të dëmtuarit- dëshmitarit M.H dhe dëshmitarëve B.J dhe A.TH, si dhe provat materiale: Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve nga i pandehuri B.M, Procesverbali i pranimit- dorëzimit të veturës së dëmtuarit , datë 14.10.2012, Procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave, lëshuar nga stacioni policor në Podujevë, me datë 13.10.2012, Foto Albumi i Njesisë së Forenzikës , datë 15.10.2012 ..., Skica e veturës “...”, me targa ..., Lista e provave materiale, përpiluar nga stacioni policor në Podujevë, nr ...i dt. 14.10.2012, Skica e vendit të ngjarjes, Raporti i ekspertizës balistike nr. ... i dt. 26.11.2012 dhe Mendimi i ekspertit mjeko- ligjor, dr. A.G, datë 28.12.2012.

I dëmtuari- dëshmitari M.H në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar: në ditën kritike unë kam qenë në shtëpi, më ka thirrë në telefon Bujar Jashari ai kishte qenë me A.TH, bashkë të tre jemi takuar në qytetin e Podujevës edhe kemi biseduar për të pirë nga një kafe, të dy kanë qenë me shtaga dhe kanë qenë me këmbë të thyera, për këtë arsyeje i kam marrë me veturën time në Podujevë edhe jemi nisur rrugës për të shkuar për Batllavë me veturën time “...” me ngjyrë të bardhë. Në ato momente kur jemi nisur diku në mes fshatit Surkish dhe Sveqel aty dikun saktësisht ka ardhë një veturë e tipit ..., ngjyrë bronz nga pas. Ajo veturë ma ka bllokuar rrugën që të mos mund të kaloj rrugën për Batllavë, saktësisht në fshatin Surkish, më ka bllokuar rrugën duke dalur përpara veturës. Në momentin kur e ka ndalur veturën ka dalur prej veturës B.M, në moment që ka dalur ky, ka dalur edhe P.G i cili ka arritur më shpejt dhe më ka bllokuar derën e veturës nga pas, para se me arritë B.. Pastaj, është afruar B.M afër xhamit të veturës time në anën e shoferit ku kam qenë duke vozitur, më ka thënë ” *ka po shkon ti knej, kah ti knej...*” e ka nxjerr revolen me dorën e djathtë nga brezi më ka goditur në anën e djathtë në pjesën e ballit për mbi sy, më ka rënë me “qyk” të armës dhe ma ka shqyer vetullën. Kam tentuar që të dal nga ana e djathtë e veturës, në të njëjtën kohë e ka futur dorën e djathtë në veturë brenda, më ka plagosur në veturë, i njëjti një herë ka shtënë në këmbën e majtë, duke më plagosur ndër gju të këmbës.

Kam dalur në anën e kundërt ku kam tentuar prap që të dal nga ana e djathtë e veturës nga dera e përparme. Kam dalur jashtë veturës dhe aty jam rrëzuar, nuk kam mundur të lëviz, nuk kam pasur lëvizje po kam qenë i vetëdijshëm dhe e kam parë P.G duke u largur prej veturës. Prej aty me armë në dorë ka hypur në veturën e tij dhe është larguar në drejtim të Shajkovcit. Pastaj, kanë ndërhyrë të dy dëshmitarët që kanë qenë me mua në veturë, B.J nuk ka dalur prej veturës, vetëm A.TH ka dalur jashtë veturës për me ma lëshu rrugën që unë me dal prej veturës, A.TH ka qenë ulur përpara veç e ka liruar ulësen dhe ka i ka thënë B. “ mos gjuaj, mos gjuaj se e vrave”, unë kam dalur vet nga vetura, sepse A. e ka liruar karrigen, mirëpo nuk më ka ndihmuar të dal nga vetura.

I njëjti ka deklaruar se ka qenë fat i mirë që unë kam qenë i ulur, se po të isha në këmbë e kisha ndonjë plumb në kokë ose në gjoks.

Dëshmitari gjithashtu ka deklaruar se i pandehuri B. nuk është ndjerë i sigurt në vete dhe e ka pasur një frikë, gjë që ka penguar të pandehurin të më godas në kokë ose gjoks, i njëjti e ka kryer veprën shumë shpejt dhe ka ikur.

Arsyeja e veprimit të B. në këtë mënyrë ndaj tij thekson se mund të jetë se i njëjti pretendon se kam hyrë në shtëpinë e tij, apo edhe një rast ku vetëm atehere e kam takuar të pandehurin B., i cili ka ardhë ma ka marrë telefonin për me thirrë kushëririn tim U.H sepse me të ka pasur një konflikt. Nuk kam ndenjur asnjëherë me Bashkimin e as me P.

Gjithashtu i njëjti në polici me datë 22.10.2012 ka deklaruar ashtu si në shqyrtim gjyqësor se Në këtë deklaratë ka theksuar se “ B. i ka mundur me më vra, por mendoj se nuk ka pasur qëllim me më vra, por ndoshta ka dashur të më frikësoj dhe nuk e di arsyen se përse”, i njëjti gjithashtu kishte deklaruar se me të pandehurin B. nuk kishte pasur ndonjë problem por vetëm në një rast kur i pandehuri B. i kishte marrë telefonin dhe ka dashur të thërras kushëririn e të dëmtuarit i cili i kishte një borxh të pandehurit B., ndërsa i dëmtuari M. nuk ia ka lënë që t’ia përdor telefonin të njëjtit.

Gjithashtu i njëjti edhe në deklarimin e tij të dhënë në Prokurori me datë 26.11.2012 i ka përshkruar veprimet e të pandehurit se në ditën kritike i ka dalë para me veturë në rrugë i pandehuri B.M, se me të nuk ka pasur ndonjë konflikt, përveç telefonin që nuk ia ka dhënë, se kur është afruar tek vetura e tij e ka e gjuajtur me armë në këmbë, mirëpo i njëjti ka deklaruar duke thënë se “ B. më ka vra sepse më ka plagosur në këmbë, mirëpo Zoti më ka shpëtuar”, ndërsa i ka mohuar deklaratimet të cilat i ka dhënë në polici , duke pretenduar se nuk janë të vërteta kur ka thënë se i pandehuri B. nuk ka pasur për qëllim të më vras, por ndoshta vetëm të më frikësoj” dhe se vetura e të pandehurit ishte dikur rreth 3, 4 m larg veturës së tij.

Dëshmitari A.TH në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se mbetet pranë deklaratimeve të dhëna në polici edhe në prokurori, i njëjti ka deklaruar se M. e njoh se e kom komshi, në telefon jemi marrë vesh me shkua me ngrënë bukë, unë kam qenë në qytet në Podujevë, kur e kam thirrur M. dhe B., diku para orës 21:00 të mbrëmjes e kam thirrë me dalë. Kemi qenë duke shkuar në Batllavë, me veturë të M.. M. ka qene duke vozitur veturën, duke shkuar rrugës, na ka parë B. dhe na ka ndalur duke na pyetur “ ku po shkoni “, i kemi thënë se po shkojmë në Batllavë, e pastaj ka folur me M..

M. ka folur diçka me ata dhe pastaj ka kërсит arma, ja kam lëshuar rrugën M. dhe kam dalur jashtë veturës ndërsa ai ka dalur prej derës time që kam qenë ulur përpara në veturë.

B. nuk i kam parë asgjë në dorë, në momentin që ka kërсит arma, unë kam qenë duke dalë nga vetura e kam pasur një këmb jashtë veturës e një brenda.

Nuk e kam parë B. duke gjuajt me armë, më kujtohet se e kam dëgjuar një krismë, në momentin kur ka kersit arma, unë kam qenë jashtë dhe si ka kërситur arma. B. ka ecur dhe ka hypur në veturën e tij. B. i ka pasur mundësi të me largoj mua, kur kam dalur nga vetura dhe i kam thënë me u ndal dhe ka pasur mundësi te gjuaj M., mirëpo një herë ka gjuajtur, ashtu siç kam thënë në polici e them edhe këtu. B. nuk ka instituar më shumë , ka hypur në veturën e tij dhe ka ecur. B. ka mundur të na mbyt të gjithëve mirëpo nuk e di a ka dashur, veç një herë ka gjuajtur dhe dhe ka hypur në veturë.

Në fund e kam dëguar M. në emergjencë me veturë në Podujevë, ndërsa B.J i cili ka qenë me ne , nuk ka dalur asnjëherë nga vetura.

Gjithashtu i njëjti në prokurori me datë 05.12.2012 i ka përshkruar veprimet e të pandehurit B., ashtu të dhëna si në deklaratimet e tjera mirëpo i njëjti ka mohuar faktin të ketë parë duke i rënë me dorës të armës në vetull të majt M. si dhe i njëjti ka potencuar faktin se nuk e ka parë me revole atë natë.

Dëshmitari B.J nuk ka prezentuar në shqyrtim gjyqësor, mirëpo me pëlqimin e palëve u lexua deklarata e tij e dhënë në polici me datë 14.03.2012, i cili kishte deklaruar së në ditën kritike se

kur ka biseduar me A. i njëjti i kishte thënë dil në rrugë se jam me M., të cilët kanë shkuar e kanë marrë atë dhe janë nisur për tek Liqeni i Batllavës. Në hyrje të fsh Shajkovc një veturë, ngjyrë ... është ndalur para nesh ku gjithashtu edhe ne jemi ndalur. Nga ajo veturë kanë zbritur dy persona, ka qenë B. me një person 27-28 vjeçar por ai nuk ka folur, ndërsa B. ka ardhur afër veturës sonë, M. e ka hapur dritaren e veturës, ndërsa B. ju ka drejtuar me fjalët “ pse ti këndeje ” dhe me një armë e ka goditur me kondak te revoles në kokë, kurse pa pritur e ka goditur me një plumb në këmbë. Në ato momente A. ka dalur nga vetura, ndërsa M. ka dalur nga ajo derë ku ka qenë i ulur A., i cili u rrëzuar për tokë, ndërsa B. me atë personin kanë vazhduar për tek vetura e tyre. gjithashtu dëshmitari edhe në deklaratimet e dhëna në Prokurori me datë 06.12.2012 i ka përshkruar veprimet e të pandehurit B., ku i njëjti u ka dalur me veturë përpara në ditën kritike dhe është ndalur dikur rreth 5-6 m para tyre, është afruar tek dritarja e veturës tek M. i pandehuri B. dhe i ka pyetur “ cka po lypni knena”, pastaj e kam dëgjuar kur M. bërtit “ of” dhe pastaj e kam dëgju krismën e armës , të cilën armë nuk e kam pa. Në momentin kur ka kërsit arma A. ka dale menjëherë nga vetura dhe pas tij M. prej derës së përparme të djatht. Pastaj B.me personin tjetër kanë ikur tek vetura e tyre. B. dhe personi i tjetër vazhduan rrugën në drejtim të Batllavës. Unë nuk kam parë revole apo mjet tjetër në duar të B. dhe atij tjetrit, as në momentin kur kanë zbritur nga vetura e kanë ardhë tek vetura jonë, e as në momentin kur janë kthyer në veturën e tyre.

Nga provat materiale, siç janë : Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve nga i pandehuri B.M vërtetohet se është sekuestruar një Armë- revole e tipit ... me doreza të drurit ngjyrë g..., kal ... me mbishkrimin ... , 8 fishek te kalibri ... me mbishkrimin në bazë ... dhe 1 karikator.

Nga procesverbali i pranimit- dorëzimit të veturës së të dëmtuarit , datë 14.10.2012 vërtetohet se vetura e të dëmtuarit nuk është dëmtuar dhe ka qenë në gjendje të rregullt.

Nga procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave, lëshuar nga stacioni policor në Podujevë, me datë 13.10.2012 vërtetohet se nuk është gjetur asgjë e dyshimt në shtëpinë dhe objektet përcjellëse të pandehurit B.M.

Nga foto albumi i Njësisë së Forenzikës , datë 15.10.2012 nr. ... vërtetohet fakti se në veturën e të dëmtuarit M.H, është gjetur gëzhøjë e armës së zjarrit në mes derës dhe karrikes së shoferit, e cila dyshohet te jetë zbrasur në ditën kritike kur ka ndodhur ngjarja, e kalibrit 6.35 mm si dhe në një shtroje të plastikes prapa karrikes së shoferit , në veturën e të dëmtuarit M.H është gjetur një predhë e cila dyshohet te jetë e kalibrit ... , gjurmët e gjakut të mbetura nga i dëmtuari.

Nga skica e veturës “...”, me targa ..., vërtetohet se në veturën janë gjetur predha e armës së zjarrit që dyshohet të jetë e kalibrit ..., gëzhjoja e armës së zjarrit që dyshihet të jetë e revoles 6.35mm , gjurmë të gjakur te mbetura nga viktima.

Nga lista e provave materiale, përpiluar nga stacioni policor në Podujevë, ... i dt. 14.10.2012, vërtetohet se në vend të ngjajres është gjetur njollë e gjakut e cila kishte qenë në një fletë misri, ne mes të rrugës te fsh. Sfeqël dhe Shajkovc ku ka ndodhur ngjarja, e cila është paraqitur edhe në skicën e përpiluar nga polici i teknikës kriminalistike.

Nga raporti i ekspertizës balistike nr. ... i dt. 26.11.2012 vërtetohet fakti se dëshmite e gjetura në vendin e ngjarjes – predha i përket një armë të kalbrit ... mm si dhe gëzhjoja e gjetur i përket kalibrit

Nga mendimi i ekspertit mjeko- ligjor, dr. A.G, datë 28.12.2012, vërtetohet se i M.H ka pësuar dëmtim të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin, dëmtimet konsistojnë në kokë nga goditja me mjet mbretës, në nën gjurin e majtë të jetë shkaktuar nga veprimi i energjisë kinetike e liruuar nga predha e armës së zjarrit.

I pandehuri B.M në shqyrtim gjyqësor është mbrojtur në heshtje, ndërsa i njëjti ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së dhënë në polici- 13.11.2012, i cili kishte deklaruar se të dëmtuarin M.H dhe A.TH i njeh, ngase kanë vjedhur në shtëpinë e tij, ndërsa nuk e njeh B.J. Në ditën kritike i njëjti ka qenë në shtëpinë e tij duke punuar në ara e ka thirrur personi J.M dhe R.J të cilët i kanë thënë se vetura e cila të ka vjedhur është tek varrezat. I njëjti ka deklaruar se pastaj ka shkuar tek varrezat e kam vërejtur veturën ...ngjyrë e ... në të cilën ishin dy persona në veturë (M.H , A.TH dhe një person tjetër) të cilët kanë futur në veturën e tyre një dritë neon të cilën e kanë vjedhur nga xhaxhai im dhe një Tv, ndërsa posa më kanë parë mua kanë me një shpejtësi shumë të madhe janë nisur për Podujevë, unë kam vazhduar pas tyre me veturën time ... dhe kur i kemi kaluar për afërsisht 500 m, i kam tejkalar dhe jam ndalur para veturës së tyre. Pasi i kemi ndalur veturat unë i kam dalur nga vetura dhe jam afruar tek dera e vozitësit dhe menjëherë e kam goditur me një boks në kokë (nuk e di saktësisht se ku), pastaj M. e ka nxjerrë revolen të cilën ma ka drejtuar mua në gjoks, unë pastaj ja kam kapur duart e tij me revole dhe duke u munduar që ta largoj revolen , revolja ka shkrepur brenda në veturë dhe më pas unë ja kam lëshuar duart me armë dhe jam nisur në drejtim të veturës sime nuk kam pasur njohur nëse është plagosur M.apo jo sepse menjëherë jam larguar nga vendi i ngjarjes, pastaj i kam dëgjuar pastaj dy krisma tjera të armës. Unë nuk kam pasur armë me vete.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata duke vlerësuar gjitha provat një nga një dhe gjitha së bashku, në përputhje me nenin 360 të KPPRK-së, për veprat penale si në dispozitivin e aktakuzës ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Nuk ishte kontestues fakti se në ditën kritike, i pandehuri B.M në fsh Shajkocv i'a ka ndërprerë rrugën të dëmtuarit M.H duke u ndalur me veturën e tij ... para veturës së dëmtuarit "...".

Nuk ishte kontestues fakti se i pandehuri B. pasi e kishte ndalur të dëmtuarin M.H, ishte afruar tek vetura e tij duke e pyetur se "ku po shkon këtej..." të cilin fillimisht e kishte goditur me kondakt të armës në pjesën e kokës, e pastaj e ka futur dorën në veturë duke shkrepur me armë në pjesën e nën gjurit tek i dëmtuari, i cili kishte pësuar lëndime të lehta trupore.

Kontestues ishte fakti se i akuzuari të ketë ndërmarrë veprimet e lartcekura me qëllim të tentimit të privimit nga jeta të dëmtuarin M.H, në drejtim të kryerjes së veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së.

Gjykata pasi analizoi dëshmitë e dëshmitarëve dhe administroi provat materiale, arriti vërtetoi se nuk janë kontestuese faktet se në ditën kritike i pandehuri B.M në fsh. Shajkocv, i'a ka ndërprerë rrugën të dëmtuarit M.H duke u ndalur me veturën e tij ... para veturës së dëmtuarit "...", pasi e kishte ndalur veturën është nisur në drejtim të veturës së të dëmtuarit M.H, ishte afruar tek vetura e tij duke e pyetur se "ku po shkon këtej" të cilin fillimisht e kishte goditur me kondakt të armës në pjesën e kokës, e pastaj e ka futur dorën në veturë duke shkrepur me armë në pjesën e nën gjurit tek i dëmtuari. Këto fakte i vërteton nga dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarit M.H dhe dëshmitarëve A.TH dhe B.J të cilat janë në përputhje me njëra tjetrën.

Nga dëshmia e dëshmitarit M.H e dhënë në shqyrtim gjyqësor, gjykata vërteton faktin se i pandehuri B.M në ditën kritike e kishte bllokuar me veturën e tij të dëmtuarin duke i dalë para me veturë, të cilët e kishte ndalur në distancë dukur rreth 5 m, me të ndaluar i është afruar duke e goditur një herë me kondakt të armës në kokë-(në pjesën e ballit), e pastaj i njëjti e futur dorën në veturëe tij duke shkrepur një herë me armë, në pjesën e nën gjurit të këmbës të dëmtuarit. Dëshmia e dëshmitarit A.TH e dhënë në shqyrtim gjyqësor, gjithashtu ishte në përputhje me dëshminë e të dëmtuarit - dëshmitarit M.H lidhur me përshkrimin e veprimeve të pandehurit B.M të ndërmarra në ditën kritike nga M. ka qenë duke vozitur veturën, duke shkuar rrugës për Batllavë, i ka ndaluar i pandehuri B., duke iu afruar tek dritarja e veturës të dëmtuarit M., të cilin e ka pyetur se “ ku po shkon...” dhe se i cili kishte deklaruar në ato momente ka kërshur arma. Ndërsa nga deklaratimet e dëshmitarit B.J të cilën e kishte dhënë në prokurori, e cila u lexua në shqyrtim gjyqësor me pëlqimin e palëve , i njëjti ka deklaruar se në ditën kritike i pandehuri B. e ka ndalur veturën diku rreth 5- 6 m para veturës së të dëmtuarit M., pastaj është afruar tek vetura e të dëmtuarit M., duke e pyetur se ku po shkon, e ka goditur me kondakt te revoles në kokë, kurse pa prituri e ka goditur me një plumb në këmbë.

Faktet e pakontestueshme gjykata i vërtetoi edhe nga provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor, se ngjarja kritike kishte ndodhur në mes të rrugës të fsh. Sfeqël dhe Shajkocv, nga u vërtetua edhe nga Raporti i vendit të ngjarës, Skica e përpiluar nga polici i teknikës së kriminalistikës dhe nga Lista e provave materiale, të cilat vërtetojnë se në vend të ngjajres është gjetur njollë e gjakut e cila kishte qenë në një fletë misri në mes të fshatit Sfeqël dhe Shajkocv. Nga Raporti i vendit të ngjarjes, fotoalbumi dhe ekzaminimet balistikë, shihet se është gjetur gëzhjojë e armës së zjarrit në mes derës dhe karrikës së shoferit, e cila dyshohet te jetë zbrasur në ditën kritike kur ka ndodhur ngjarja, e kalibrit ...mm si dhe në një shtroje të plastikes prapa karrikës së shoferit , në veturën e të dëmtuarit M.H është gjetur një predhë e cila dyshohet te jetë e kalibrit 6.35 mm , gjurmët e gjakut të mbetura nga i dëmtuari dhe ekspertiza mjeko ligjore nga e cila u konstatua se i dëmtuari M.H ka pësuar lëndime të lehta trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin, dëmtimet konsistojnë në kokë nga goditja me mjet mbretës, në nën gjurin e majtë të cilat janë shkaktuar nga predha e armës së zjarrit.

Provat materiale përkojnë të janë në përputhje me dëshminë e të dëmtuarit dhe dëshmitarëve të cilat gjykata konsideron se janë fakte të pakontestueshme.

Për gjykatën ishte konstestues fakti se i akuzuari të ketë ndërmarrë veprimet e lartcekura me qëllim të tentimit të privimit nga jeta të dëmtuarin M.H, në drejtim të kryerjes së veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të këtij fakti konstetues, analizoi dëshminë e të dëmtuarit-dëshmitarit M.H të dhënë në shqyrtim gjyqësor , prokurori dhe polici.

Deklarimet e dëshmitarit i konsideron si kundërthënëse me vetveten, në drejtim të veprës penale Vrasjes në tentativë, pasi që i njëjti ka deklarime të ndryshme në polici dhe në prokurori nga ato që ka thënë në shqyrtimin gjyqësor, ngase në Polici në deklaratimin e dhënë me datë 22.10.2012 kishte deklaruar “*B. ka mundur me më vra, por mendoj se nuk ka pasur qëllim me më vra, por ndoshta ka dashur të më frikësoj dhe nuk e di arsyen se përse*”, ndërsa në Prokurori kishte deklaruar se “*B. më ka vra, mirëpo Zoti më ka shpëtuar*” ndërsa në shqyrtim gjyqësor i njëjti ka deklaruar se “*B. nuk është ndërje i sigurt në vete dhe e ka pasur një frikë, gjë që ka penguar të pandehurin të më godas në kokë ose gjoks, i njëjti e ka kryer veprën shumë shpejt dhe ka ikur*”. Andaj nga dëshmia e tij, ku i ka përshkruar veprimet e ndërmarra nga i pandehuri, rrjedh se i pandehuri B.M nuk kishte për qëllim të kryente veprën penale të lartcekur, gjë që vërteton se nuk ka ekzistuar dashja e të njëjtit që të privoj nga jeta të dëmtuarin M.H, ngase i pandehuri B. nuk

kishte pasur asnjë pengesë që të privonte nga jeta të dëmtuarin M.H, nuk ka hasur në rezistencë të dëmtuarit e as të dëshmitarëve A.TH dhe B.J të cilët kishin qenë së bashku në veturë me të dëmtuarin M.H i cili ishte duke e drejtuar veturën, gjithashtu i pandehuri B., menjëherë pas veprimit të ndërmarr është larguar në drejtim të veturës së tij, e cila ishte në afërsi dikur rreth 5 m nga vetura e të dëmtuarit, gjë që ka mundur përsëri të gjuaj me armë në drejtim të tij dhe ta godas dhe ta privoj nga jeta, mirëpo i njëjti menjëherë është larguar pas ndërmarrjes së veprimeve të tij.

Gjithashtu gjykata ka analizuar edhe dëshminë e dëshmitarit A.TH të dhënë në shqyrtim gjyqësor, e cila në tërësi ishte në përputhje me dëshminë e dëshmitarit M.H lidhur me përshkrimin e veprimeve të pandehurit B.M të ndërmarra në ditën kritike edhe nga dëshmia e tij rrjedhë se M.ka qenë duke vozitur veturën, duke shkuar rrugës për Batllavë, i ka ndaluar i pandehuri B., duke iu afruar tek dritarja e veturës të dëmtuarit M., të cilin e ka pyetur se ‘‘ ku po shkon...’’ dhe se në ato momente ka kërësitur arma, i njëjti i’ a kishte lëshuar rrugën Milotit të dalë nga vetura, nga ulësja e parë e pasagjerit, ku kishte qenë ulur dëshmitari A., duke mos insistuar të gjuaj më shumë, ka pasur mundësi që të gjuaj M. mirëpo nuk ka insistuar më. Nga kjo dëshmi vërtetohet fakti se i pandehuri B. me veprimet e ndërmarra nuk ka tentuar të privonte nga jeta të dëmtuarin, pasi që i njëjti, pasi që ka gjuajtur me armë një herë tek i dëmtuari, nuk ka insistuar më të, edhe pse ka pasur mundësi përsëri të gjuaj me armë të dëmtuarin M., gjithashtu i pandehuri nuk ishte penguar as nga pala e dëmtuar, e po ashtu as nga dëshmitari, që të ndërmerre të gjitha veprimet të kryer veprën penale të Vrasjen në tentativë.

Gjykata ka analizuar edhe deklaratimet e dëshmitarit B.j të cilat i kishte dhënë në Polici dhe në Prokurori, të cilat me pëlqim të palëve u lexuan në shqyrtim gjyqësor dhe konsideron se të njëjtat janë në përputhje me dëshminë e të dëmtuarit M.H dhe dëshmitarit A.TH, i cili e ka përshkruar se në ditën kritike i pandehuri B. e ka ndaluar veturën diku rreth 5- 6 m para veturës së të dëmtuarit M., pastaj është afruar tek vetura e të dëmtuari M., duke e pyetur se ku po shkon, e ka goditur me kondak te revoles në kokë, kurse pa prituri e ka goditur me një plumb në këmbë. Në ato momente A. ka dalur nga vetura, ndërsa M. ka dalur nga ajo derë ku ka qenë i ulur A., i cili u rrëzua për toke, ndërsa i pandehuri B. me një person tjetër kanë vazhduar për tek vetura e tyre. Edhe nga kjo dëshmi vërtetohet fakti se i pandehuri B.M nuk kishte tentuar dhe nuk kishte pasur për qëllim të privonte nga jeta të dëmtuarin M.H, pasi që me të shkrepur një herë me armë tek pjesa e gjurit tek i dëmtuari M.H i njëjti është larguar tek vetura e tij e cila kishte qenë e ndaluar në distancë prej 5-6 m nga veura e të dëmtuarit, e ku kjo distancë e afërt e veturave tregon se nëse i pandehuri kishte tentuar të privoj nga jeta të dëmtuarin, i njëjti i ka pasur të gjitha mundësit, gjithashtu edhe nga deklaratimet e këtij dëshmitari vërtetohet fakti se i pandehuri, nëse kishte dashur të privonte nga jeta të dëmtuarit, ka mundur të ndërmerre të gjitha veprimet në atë drejtim, ngase nuk ka hasur në rezistencë të dëmtuarit e as të personave të pranishëm në veturë të cilët ishin me të dëmtuarin, apo të dëshmitarëve, ngase të njëjti nuk kanë bërë asnjë përpjekje që të i kundërvihen veprimeve të pandehurit.

I akuzuari në shqyrtim gjyqësor është mbrojtur në heshtje, duke deklaruar se qëndron pranë deklaratimeve të dhëna më parë. Në deklaratimin e tij të dhënë në Polici, i njëjti në tërësi i ka mohuar veprimet e tij të ndërmarra në drejtim të veprës penale për të cilën është akuzuar. I pandehuri nuk e ka kontestuar faktin se në ditën kritike rrugës për Podujevë, e ka tejkaluar të dëmtuarin me veturën e tij dhe është ndaluar në distancë prej 500m para tij, pasi që ka dëgjuar nga personat J.M dhe R.J se personi që ka vjedhur në shtëpinë e tij është i dëmtuari M.H, duke u identifikuar nga vetura e tij të cilën ishte duke e drejtuar atë ditë, e pastaj i pandehuri e ka ndjekur nga pas me veturë dhe e ka ndaluar, mirëpo ka mohuar të ketë ndërmarrë veprime në drejtim të veprës penale Vrasje në tentativë, i njëjti gjithashtu nuk e ka kontestuar faktin se e ka goditur në kokë të

dëmtuarin M., duke pretenduar se veprimin e ka ndërmarrë duke e goditur me ‘‘ boks- dorë’’, mirëpo ka mohuar faktin të ketë bartur armë me vete në ditën kritike dhe ti ketë gjuajtur me armë, duke pretenduar se i dëmtuari M. ka pasur revole të cilën ka tentuar të ia largoj revolen, mirëpo e njëjta ka shkrepur brenda në veturë, duke mos qenë në dijeni se a është plagosur i dëmtuari M..

Gjykata këto pretendime i ka marrë si pjesërisht të bazuara, mirëpo gjykata rikujton se vërtetimi i fakteve në procedurë penale realizohet nëpërmjet procesit të të provuarit, në dëm të akuzuarit mund të merret fakti vetëm atëherë kur është vërtetuar pa mëdyshje, kur ekzistimi i tij qëndron përtej dyshimit mirë të bazuar, e në rastin konkret nuk ka arritur të vërtetoj se ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata analizoi edhe deklaratimet e mbrojtësit të pandehurit Av. Naim Rudari të dhëna në shqyrtim gjyqësor në fjalën përfundimtare, ku i njëjti ka pretenduar se i mbrojturi i tij nuk ka përmendur asnjë pengesë apo vështirësi që ka pasur B.M që të kryente vrasjen ,nëse ka pasur qëllim të tillë dhe cilat ishin pengesat për të realizuar ai qëllimin e vet , e që vepra ngeli në tentativë, apo kishte rrethana që B.M ka hequr dorë nga vrasja. Se nuk nuk ka ekzistuar qëllimi, dashja për kryerjen e veprës penale Vrasja, sikur i mbrojturi i tij do të dëshironte të kryente veprën penale të Vrasjes, i njëjti do ta kryente , pasi që nuk ka pasur asnjë pengesë për të kryer një veprim të tillë, sepse nuk ka pasur motiv , shkas e arsye të më hershme që ai për të vendosur për të kryer veprën penale të vrasjes.

Gjykata këto pretendime i konsideron si të bazuara, ku arsyetimet i ka dhënë në disa pjesë të këtij aktgjykimi, duke marre parasysh rrethanat konkrete të gjendjes faktike, krahasimin e deklaratave të dëshmitarëve dhe provave materiale.

Pas administrimit të provave, të gjitha të cekura më lartë, gjykata me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetoj se i pandehuri të ketë ndërmarrë veprime me qëllim të tentoj të privoj nga jeta të dëmtuarin M.H. Gjykata, aktgjykim e saj e mbështet në dispozitën nga neni 363 paragrafi 1 pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton që *‘‘Gjykata merr aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza nëse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën për të cilën është akuzuar.’’* Duke ju referuar nenit 360 paragrafi 1 të KPPRK-së konsideron se objekt i akuzës ka qenë vepra penale për të cilën i akuzuari është akuzuar po ashtu në aspektin procedural penal i akuzuari mbulohet nga parimi i prezumimit të pafajësisë si dhe parimi In Dubio Pro Reo (*Mëdyshjet lidhur me provat dhe faktet si dhe zbatimit të ligjit zbatohen në favor të të pandehurit*), gjithashtu i akuzuari nuk është i detyruar që ta provoj fajësinë apo pafajësinë e tij, e në rastin konkret gjykata konsideron se nuk ka prova bindëse se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuara ndaj gjykata ka marrë aktgjykim lirues lidhur me veprën penale Vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPRK-së.

Sa i përket pjesës të aktgjykimit refuzues është marr në kuptim të nenit 362 par.1, pika 1.3 të KPRK-së, për shkak se vepra penale është përfshirë në Ligjin për Amnisti 04L/209 i vitit 2013, ku sipas nenit 3 par1, pika 1.1.10 *‘‘Lirohen plotësisht nga ndjekja penale apo vuajtja e plotë e dënimit, kryesit e veprave ... – Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve (neni 374)’’*.

Vendimi mbi konfiskimin e armës u mor konform nenit 374 par.3 *‘‘ konfiskohet pistoletat e tipit ‘... me tetë fishek, e kalibrit ... mm.*

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale të cilat mbesin barrë e buxhetit të gjykatës marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil u mor konform nenit 462 të KPPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart dhe konform nenit 362, 363 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 210/13 26.04.2024**

**Kryetarja e trupit gjykues - gjyqtarja,
Alltën Murseli**

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.